



Në bazë të nenit 149 pika 1 të Ligjit mbi Arsimin e lartë (“Gazeta Zyrtare e RM”nr. 82/18 “Gazeta zyrtare e RMV” nr. 178/21), Rregullores për kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet deridiplomike në Fakultetin të Shkencave Islame - Shkup, si dhe në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup të miratuar në mbledhjen e 72-të e rregullt të mbajtur më 30. 04. 2026. Dekanati i Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup, shpall:

K O N K U R S

për regjistrimin e studentëve në studimet deridiplomike në programin studimor Shkencat Islame në Fakultetin e Shkencave Islame – Shkup, f. Kondovë p.n. në vitin akademik 2026/2027

I. Statusi i studimit dhe numri i studentëve të cilët duhet të pranohen;

Nr.	Fakulteti i Shkencave Islame Shkup	Të rregullt	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Numri i përgjithshëm i studentëve	Kohë zgjatja e studeimeve
1	Shkencat Islame	50	100	50	200	100	I – VIII sem.
Gjithsej:		50		50		100	

- Programi studimor do të zhvillohet në rrugën p.n. f. Kondovë – Shkup.

II. Kushtet dhe kriteret për regjistrim:

- Të drejtë regjistrimi për studime deridiplomike kanë kandidatët që kanë mbaruar Medresenë “Isa Beu” në Shkup dhe paralelet e saja, kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme katërvjeçare edhe atë:
 - Kandidatët që kanë mbaruar pas vitit shkollor 2020/2021 me maturë shtetërore,
 - Kandidatët që kanë mbaruar në vitin shkollor 2019/2020 pa maturë shtetërore,
 - Kandidatët që kanë mbaruar maturë shtetërore para vitit shkollor 2019/2020,
 - Kandidatët me arsim të kryer para vitit shkollor 2007/2008, dhe nuk kanë kryer maturë shtetërore, si dhe
 - kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme katërvjeçare (me maturë ndërkombëtare të kryer)
- Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt dhe studentë me korrespondencë, me bashkëfinancim të studimeve.
- Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit nga arsimimi i mëparshëm. Ngjashmërinë e vërteton dhe e shpall Fakulteti. Kandidatët nga kjo pikë regjistrohen me bashkëfinancim të studimeve, varësisht a regjistrohen si student të rregullt ose me korrespondencë.
- Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë. Kandidatët mund të fitojnë më së shumti **100 pikë**, edhe atë: sukcesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët (si dhe nga lëndët e rëndësishme për programin shkollor) merr pjesë me **60 pikë**, ndërsa sukcesi i arritur nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve merr pjesë me **40 pikë**.
- Kandidatët do të rangohen me mbledhjen e pikëve të fituara nga këto dy baza.

a1. Llogaritja e pikëve nga sukcesi i arsimit të mesëm:

Llogaritja e pikëve vetëm nga sukcesi i arritur në arsimin e mesëm, bëhet në këtë mënyrë: mblidhen të gjitha notat që janë përfshirë në dëftesat, nga të gjitha vitet, shuma e fituar pjesëtohet me numrin e notave dhe kështu, sukcesi mështar i fituar shumëzohet me 12. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti **60 pikë**.



a2. Llogaritja e pikëve nga kontrollimi i talentit të kandidatit:

Vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve bëhet me fitimin nga **0** deri në **40 pikë**. Kontrollimi ka karakter eliminues. Nuk rangohen kandidatët të cilët kanë fituar më së paku **10 pikë**.

III. Seleksionimi i kandidatëve

1. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Dekanati formon Komision Qendror të Konkursit.
2. Për llogaritjen e pikëve nga sukcesi i arritur nga arsimit i mesëm dhe nga sukcesi i arritur nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve, Dekanati formon Komision për kontrollin e njohurive dhe diturive.
3. Komisioni Qendror i Konkursit e përcjell realizimin e Konkursit, kujdeset për respektimin e përpiktë të dispozitave të Konkursit, jep udhëzime dhe mendime në procesin e realizimit të tij.
4. Rangimin e kandidatëve e kryen Komisioni Qendror i Konkursit i Fakultetit.
5. Komisioni Qendror i Konkursit, në tabelat e shpalljeve të Fakultetit e shpall rangimin sipas poenëve nga sukcesi i arsimit të mesëm (shumën e fituar), dhe nga rezultatet e kontrollimit të njohurive dhe talentit.
6. Pas shpalljes së rang listës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni Qendror i Konkursit, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura.
7. Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike-gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve, dhe i njëjti i drejtohet Komisionit Qendror të Konkursit. Aktvendimi i Komisioni Qendror është përfundimtar. Vendimet për kundërshtimet shpallen në Fakultet.
8. Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni Qendror i Konkursit shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (**Rang lista përfundimtare**), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve.
9. Nëse pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të paplotësuara, atëherë regjistri i studentëve bëhet në afatin e dytë dhe të tretë regjistrues.
10. Nëse në afatin e parë regjistrues, gjatë rangimit, në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me numër të barabartë të pikëve (më së shumti pesë kandidatë), Fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Por, nëse numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5 (pesë), atëherë Fakulteti kandidatët e tillë i rangon sipas kritereve plotësuese: çmimet e fituara në garat republikane dhe ndërkombëtare, certifikatat e fituara për njohje të gjuhëve të huaja në nivel më të lartë etj.
11. Studentët e rregullt regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studimeve, në shumë prej **100 euro** për një semestër, respektivisht **200 euro** për një vit akademik, me kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV. Pagesa e kompensimit mundë të kryhet në dy këste të barabarta.
12. Kompensimi nga paragrafi 1 i kësaj pike, studentët e dorëzojnë gjatë periudhës së përgjithshme të studimeve.
13. Dekanati sjell Udhëzim të veçantë për realizimin e Konkursit.

IV. Regjistrimi i studentëve me korrespondencë

1. Student me korrespondencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studentë të rregullt.
2. Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraprak llogariten: invalid, i cili nuk është në gjendje ta ndjek mësimin e rregullt; sëmundje e rëndë afatgjate, e cila pamundëson vijim të rregullt të mësimit më tepër se një semestër; prind i fëmijës deri sa zgjatë pushimi i lehonisë.
3. Studentët me korrespondencë regjistrohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit. Studentët me korrespondencë regjistrohen me vetëfinancim të studimeve.
4. Studentët me korrespondencë regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studimeve, në shumë prej **200 euro** për një semestër, respektivisht **400 euro** për një vit akademik, me kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV. Pagesa e kompensimit kryhet në dy këste të barabarta.
5. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespondencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar, ose vërtetim mjekësor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.
6. Studentët me korrespondencë gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.



V. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit

a) Shtetasit e huaj

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs.
2. Seleksionimi i shtetasve të huaj që paraqiten për studim **kryhet me anë të kontrollit të diturive dhe aftësive**.
3. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë dëftesë për mbarimin e arsimit të mesëm, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, certifikatë për gjendjen shëndetësore dhe vërtetim nga Ministria e Punëve të Brendshme për **lejeqëndrim** në RMV. Shtetasit e huaj, **diplomën** për mbarimin e shkollës së mesme, si dhe **dëftesat** për të gjitha klasat, duhet t'i kenë të **nostrifikuara në RMV**.
4. Pagesa e studimeve për studentët e rregullt, shtetasit e huaj për vitin shkollor 2026/27 është në vlerë prej **100 euro për një semestër** respektivisht **200** për një vit akademik, kurse studentët me korrespondencë paguajnë **200 euro për një semestër** respektivisht **400 euro** për një vit akademik.
5. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë Veriore.
6. Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim. Shtetasit e huaj pranohen në Listë të veçantë dhe numri i tyre nuk tejkalon 10%.

b) Mërgimtarët dhe shtetasit e RMV-së me arsim të mesëm të kryer në tërësi dhe me arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë tanë dhe kandidatët shtetas të RMV, që **arsimin e mesëm të plotë** e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen jashtë kuotave, me bashkëfinancim të studimeve.
2. Seleksionimi i kandidatëve nga pika 1 **kryhet me kontrollim të njohurive dhe aftësive**.
3. Kompensimet për studime të kësaj kategorie të studentëve vlejnë rregullat për pagesë **si për kandidatët nga kreu -V-**.
4. Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë **diplomë të nostrifikuar** si dhe **dëftesa të nostrifikuar** për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit.
5. Kandidatët shtetas të RMV-së, që **një pjesë të arsimit të mesëm** e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen me kushte dhe kriteret e njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë Veriore, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuar për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit.
6. Këta kandidatë rangohen në rang - listë të veçantë, kurse do të pranohen ata kandidatë të cilët do të fitojnë aq pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kuadër të kuotës së rregullt ose me korrespondencë. Numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti **10%**.

VI. Afatet për paraqitje, kontrollimin e njohurive dhe aftësive dhe regjistrimi

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2026/27	Afati i I i regjistrimit	Afati i II i regjistrimit	Afati i III i regjistrimit
	kontroll të njohurive dhe talentit		
Aplikimi online (www.fshi.edu.mk)	15 Qershor – 02 Shtator	03 - 09 Shtator	10-23 Shtator
Paraqitja e kandidatëve	01-02 Shtator 2026	07-09 Shtator 2026	21-23 Shtator 2026
Kontrollimi i njohurive dhe aftësive	03 Shtator	10 Shtator	24 Shtator
Shpallja e listës preliminare	04 Shtator	11 Shtator	25 Shtator
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	07 Shtator	14 Shtator	28 Shtator
Regjistrimi i kandidatëve	09 - 11.09.2026	15 - 18.09.2026	29 - 30.09.2026

Numri dhe kushtet për regjistrim të kandidatëve në afatin e dytë do të përcaktohet me Konkurs plotësues për regjistrimin e studentëve në studimet deridiplomike i cili do të shpallet në web faqen e fakultetit.



VII. Dokumentet për paraqitje dhe regjistrim

Gjatë **paraqitjes** për regjistrim në fakultetet, kandidatët i dorëzojnë këto dokumente:

1. formulari i plotësuar nga aplikimi online: www.fshi.edu.mk;
2. fletëparaqitje për regjistrim;
3. dëftesa origjinale dhe kopje për të gjitha klasat;
4. dëftesë për kryerjen e shkollës së mesme origjinal dhe kopje;
5. certifikatë nga libri amzë i të lindurve origjinal dhe kopje;
6. referencë nga muftinia përkatëse;
7. vërtetim për nënshtetësi të RMV (Certifikat ose Vendim);
8. vërtetim për pagesat e:
 - **1000 dinarë** në emër të taksave administrative;
 - **600 dinarë** mjete plotësuese për secilën lëndë të theksuar në Listën shtesë-1, të Programit studimor përkatës, në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive.

Gjatë **regjistrimit**, kandidatët e pranuar duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit).
2. Tri fotografi (një fotografi 6 x 9 dhe dy 4 x 5 c.m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
 - **500 dinarë**, në emër të dhënies së Indexit.
 - **400 dinarë** pagesa për fletoret e provimit.
 - **300 dinarë** pagesa për Revistën mujore "Hëna e Re".
 - **100 dinarë** në emër të Kuvendit studentorë në FSHI.
 - **pagesë e mjeteve për semestrin e parë, varësisht nga statusi i studimit të bëhet në xhiro-llogarinë e Fakultetit: HALKBANK AD SHKUP 270070852730133.**

Vërejtje: Dokumentacioni origjinal i cili dorëzohet gjatë aplikimit i njëjti në fazën e regjistrimit u kthehet kandidatëve por pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar.

Lista 1 - Lloji dhe përmbajtja e testimit/seleksionimit plotësues të kandidatëve

Provimi pranues do të mbahet vetëm nga lënda e Kur'ani Kerimit dhe atë:

- A. Lexim nga Kur'ani Kerimi,
- B. Texhvid dhe
- C. Pjesë të nxërrë përmendësh nga Kur'ani Kerimi.

Provimi në afatin e parë të pranimit do të mbahet më: 03. 09. 2026 (e enjte) ora 10:⁰⁰ h, në afatin e dytë provimi do të mbahet më: 10. 09. 2026 (e enjte) në ora 10:⁰⁰ dhe afati i tretë i provimit pranues do të mbahet më: 24. 09. 2026 (e enjte) në ora 10:⁰⁰ në hapësirat e Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup. (për informata më të hollësishme vizitoni faqen zyrtare të Fakultetit <http://www.fshi.edu.mk>).

Ky akt shpallet në gazetën e Bashkësisë Fetare Islame "Hëna e Re".

Nga një kopje e aktit u dorëzohet:

- Bashkësisë Fetare Islame të RMV,
- Muftinive të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe
- Arkivit të Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup.

Dekan

Prof. Dr. Abdulxhemi Nesimi